

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Gyltene Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen administrative sipas padisë së paditëses B. K. nga fshati S., komuna e L., me vendqëndrim në Gjermani, të cilën me autorizim e përfaqëson av. S. K. nga L., kundër vendimit të të paditurës Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), Agjencia e Regjistrimit Civil (ACR) në Prishtinë, nr..... të datës ....., lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, AA.UZH.nr.182/2017, datë 26.9.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur mëdatë 15.11.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I.Aprovohet** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditëses B. K., ndërsa ndryshohen aktgjykimet e Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.182/2017 dt.26.09.2017 dhe i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti administrativ A nr.212/15 dt.10.03.2017.

**II.Aprovohet** padia e paditëses B. K., ndërsa ndryshohet Vendimi i të paditurës- Agjencionit mbi Regjistrimin Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Prishtinë nr.... dt..... dhe Vendimi i Komunës së Gjilanit nr.... dt.....

**III.Detyrohet** organi administrativ i shkallës së parë që në regjistrin e gjendjes civile të bëjë korrigjimin për paditësen B. K. (mbiemri i vajzërisë M.), ashtu që në rubrikën ku shënohet data, muaji dhe viti i lindjes, në vend të datës .... të shënohet data .....

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative, AA.UZH.nr.182/2017 e datës 26.9.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, A.nr.2124/2015, datë 10.2.2017, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses për anulimin e vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), Agjencia e Regjistrimit Civil (ACR) në Prishtinë, nr..... të datës .....

Paditësja, kësaj gjykate në afat ligjor i ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër aktgjykimit të apeluar, duke theksuar se ky është

marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, prandaj ka propozuar që aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që padia dhe kërkesëpadi të miratohen dhe në Regjistrin e Gjendjes Civile, në rubrikën ku shënohet data, muaji dhe viti i lindjes të përmirësohen nga data .... më datë .....

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimeve të atakuar, kërkesës së paditëses dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtzakonshëm është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e Komunës së Gjilanit - Drejtoria e administratës së Përgjithshme nr..... dt....., paditëses i është refuzuar kërkesa për korrigjimin e datëlindjes nga data .... në datën ....., me arsyetim se nuk posedon dokumentacion të mjaftueshëm për t'iu korrigjuar datëlindja. Lidhur me ankesën e paditëses, e paditura Ministria e Punëve të Brendshme -Agjencia e Regjistrimit Civil ka marrë vendimin nr....., me të cilin e ka refuzuar ankesën e paraqitur. Paditësja ka paraqitur padi me të cilën ka nisur konfliktin administrativ, duke propozuar anulimin e vendimit të të paditurës, në mënyrë që të bëhet korrigjimi, dhe në regjistrin e gjendjes civile në rubrikën ku shënohet data, muaji dhe viti i lindjes të përmirësohet nga dt..... në dt..... Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.2124/2015 dt.10.03.2017 e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Me aktgjykimin e apeluar është refuzuar ankesa dhe është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë.

Gjykata Supreme, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim ka gjetur se gjykatat e të dy instancave me rastin e vendosjes gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, respektivisht gabimisht kanë zbatuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-003 për Gjendjen Civile dhe të Udhëzimit Administrativ nr.01/2013-ARC për korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara.

Gjykata Supreme vlerësoj se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale dhe gabimisht kanë zbatuar dispozitat e nenit 23 të Ligjit nr.04/L-003 për Gjendjen Civile dhe nenit 6 të UA nr.01/2013-ARC për korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara. Kjo Gjykatë vlerësimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët nuk mund ta merr si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimet e goditura përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Shkeljet esenciale të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84.2 të LPA është paraparë se akti administrativ i kontestuar, duhet patjetër të përmbajë, përveç tjerash, edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti etj.Neni 85 (LPA) ka përcaktuar që përveç rasteve kur ligji vet parashikon dhënien e arsyeve, duhet jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht: mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për rishqyrtim apo ankimet, përbëjnë një

vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar et. Arsyetimi duhet formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe arsyetimin e provave me të cilat është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike. Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barsvlerëshëm me mungesën e arsyetimit. Është i pamjaftueshëm referimi vetëm në disa dispozita ligjore dhe të konstatohet se ankesa e palës është e pabazuar, pa dhënë shpjegime dhe arsye në bazë të cilave organi administrativ ka marrë vendim, përkundër asaj se paditësja ka paraqitur të gjitha prova relevante që mbështesin kërkesëpadinë e saj: vërtetimi i lëshuar nga SHF 'I. O.' në B., çertifikata e lindjes UNMIK e vitit ....., pasaporta e ....., çertifikata e martesës e ....., pasaporta e R.Kosovës e .... me validitet deri në vitin ....., Në të gjitha këto prova shihet në mënyrë të pakontestueshme data e saktë e lindjes së paditëses, e që është data .....

Mbi këtë gjendje, Gjykata Supreme nuk mund të merr si të ligjshëm aktgjykimet e kontestuara dhe vendimet e organeve administrative, për arsye se janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, por edhe zbatimit të gabuar të Ligjit nr.04/L-003 për Gjendjen Civile dhe të UA nr.01/2013-ARC për korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara, andaj vendosi ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA UZH nr.182/2017 dt.26.09.2017, aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dep.administrativ A.U.nr.2124/15 dt.10.03.2017, ta aprovoj padinë e paditëses dhe ta ndryshoj Vendimin e ACR nr..... dt....., si dhe Vendimin e Komunës së Gjilanit. Njëkohësisht detyroj organin administrativ të shkallës së parë që në regjistrin e gjendjes civile të bëjë korrigjimin e paditëses B. K., ashtu që në rubrikën ku shënohet data, muaji dhe viti i lindjes të përmirësohet nga dt..... me dt.....

Kjo Gjykatë thekson, e në bazë të nenit 65 LKA, se ky aktgjykim ka karakter të detyrueshëm në raport me organin administrativ të shkallës së parë.

Nga sa u tha më sipër, e në mbështetje të nenit 54 par.2 të LKA, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË**  
ARJ.UZVP.nr.61/2017, më datë 15.11.2017

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetar kolegji,  
Nebojsha Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi